



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 08

Datë: 26. 04. 2017, ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesues të mbledhjes: Binak Vishaj, anëtar i KQZ-së dhe Valdete Daka, kryetare e KQZ

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Eshref Vishi, Nenad Rikallo, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Binak Vishaj dhe Valdete Daka, Kryesues të mbledhjes,

- *Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes të KQZ-së nr.06 dhe 07 /2017;*

2. Raport i Këshillave të KQZ-së

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

- *Shqyrtim i dhe miratimi i Projektit për zhvillimin e Aplikacionit online për Regjistrimin e Votuesve jashtë Kosovës;*

- **Këshilli për Çështje Ligjore;**

- *Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal në Prizren, Gjilan dhe Ferizaj;*

- *Shqyrtimi dhe miratimi i procedurave për vlerësimin e kriterëve të zotësisë juridike, për fitimin e së drejtës së votës për votimin jashtë Kosovës;*

- **Këshilli për Buxhet dhe Financa;**

- *Shqyrtimi i Raportit të buxhetit dhe shpenzimet për TM1-2017;*

3. Komiteti i Auditimit;

- *Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës të Komitetit të Auditimit për vitin 2016;*

- *Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës të Komitetit të Auditimit për vitin 2017;*

- *Njoftim për Raportin e Auditimit të Prokurimit për vitin 2016;*

4. Të ndryshme

1. Hyrie

z. Binak Vishaj dhe Valdete Daka, Kryesues të mbledhjes,

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes të KQZ-së nr.06 dhe 07 /2017;

Binak Vishaj: Mirë se keni ardhur....Me autorizim të znj. Daka për shkak të angazhimeve të saj që ka, më ka autorizuar që unë sot, të udhëheqë me këtë mbledhje...Para jush, e keni rendin e ditës...! A ka dikush ndonjë propozim, sugjerim...?

Betim Gjoshi: Për plotësim në bazë të agjendës, i kemi të shënuar disa komuna për zëvendësim, e disa jo...

Nenad Rikalo: Në mbledhjen e fundit, kam kërkuar që të na sillen shpjegime rreth problemeve të Listës Serbe. Por, e shoh që asgjë nuk ka ndodhë, nuk kemi përpara asnjë lloj shpjegimi, raporti apo ndonjë informacion nga zyra... Edhe më tutje, nuk kam qasje në dokumentacionin që është në proces. Në këtë mbledhje, ajo që dua të them është se ne jemi plotësisht të paralizuar, dhe nuk po mundemi që të veprojmë! Ka ardhur një kërkesë që të lirohen mjetet tona që na takojnë, dhe kjo kërkesë është në zyre...Dhe, mendoj që duhet të informohemi në këtë mbledhje, dhe të shohim çështjen sepse, ne jemi subjekt parlamentar...

Binak Vishaj: Me këto dy propozime të Betimit dhe të Nenadit (në të ndryshme), kush është për këtë rend dite...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan unanimisht rendin e ditës.

Binak Vishaj: Në vazhdim, kemi shqyrtimin dhe miratimin e procesverbaleve të mbledhjes nr. 6 dhe 7/ 2017. A ka dikush diçka, nëse jo kush është për miratimin e tyre...?

Betim Gjoshi: Në dy raste, nuk është prezantuar arsyeja se pse s'kam votuar, dhe pse nuk kam votuar. Te mbledhja 7...

Adnan Rrustemi: Unë, nuk është se ju japë ndonjë rëndësi procesverbaleve...Por, kemi thënë se të paktën qëndrimet, thelbin me reflektuar...Kur bëhet fjalë të aplikacioni - on line, e që e kishim edhe sot në mbledhje, unë sado që kam shprehur dilema, unë kam qenë për që ky aplikacion me u realizuar... Pra, le të theksohen në fakt që, unë jam për...

Me këto dy vërejtje në proces të përmirësimit, anëtarët e KQZ-së miratuan këto dy procesverbale.

2.Raport i Këshillave të KQZ-së

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

- *Shqyrtim i dhe miratimi i Projektit për zhvillimin e Aplikacionit online për Regjistrimin e Votuesve jashtë Kosovës;*

Adnan Rrustemi: Po e lidhi me atë që thashë edhe lidhur me procesverbalin: ju e dini që në mbledhjen e kaluar, ne e kemi shqyrtuar rekomandimin e këshillit të OZ-së kur bëhet fjalë për regjistrimin e votuesve jashtë vendit në mënyrë on-line. Kemi diskutuar gjerë e gjatë...Nuk e di, nëse ka ndryshuar diçka...Por, unë kam qëndrimin tim të njëjtë...A është kjo mbledhje e duhur që të shqyrtohet...?

Binak Vishaj: A ka ndryshuar diçka kryesues nga mbledhja e kaluar...Ne, e kemi vendosur që KQZ ta mbajë një mbledhje të veçantë për këtë pikë të rendit të ditës...! A është mbajtur mbledhja...? A ta respektojmë vendimin e KQZ-së që kjo pikë të shtyhet në mbledhjen tjetër...!

Betim Gjoshi: Unë, nuk jam që të mos e respektojmë vendimin e KQZ-së. Por, kemi thënë që të mbahet një mbledhje qoftë edhe formale ku diskutojmë, një tip i mbledhjes më të gjerë që të mbërrihet deri te qëllimi... po: Ky projekt të thuhet është i garantuar, dhe pastaj me ecë përpara...me e miratuar projektin...Ku bëhen prezantime edhe me sjalde, dhe ku ne mund të bëjmë pyetje, debat...

Binak Vishaj: Kjo është dashur me ndodhë para se të bëhet hartimi i agjendës. Tash, kjo është pjesë e rendit të ditës: Pra, a jeni ta shqyrtojmë apo ta shtyjme...Mendoj që, mbasi edhe KOZ nuk e ka shqyrtuar mendoj që duhet ta shtyjme...Atëherë, a pajtoheni...? Kush është që kjo pikë të shkoj për një mbledhje tjetër...?

Anëtarët e KQZ-së, u pajtuan që kjo pikë të ndërpritet që të shqyrtohet më tutje dhe të shtyhet për mbledhjen tjetër, me një votë abstenimi (Adnan Rrustemi)

3.Këshilli për Çështje Ligjore

- *Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal në Prizren, Gjilan, Ferizaj, Drenas dhe Han të Elezit.*

- *Shqyrtimi dhe miratimi i procedurave për vlerësimin e kriterëve të zotësisë juridike, për fitimin e së drejtës së votës për votimin jashtë Kosovës.*

Sami Hamiti: Ju faleminderit kryesues...I kemi dy pika të cilat i kemi shqyrtuar në këshill...Njëra është: shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për zëvendësimin e anëtarëve të kuvendeve komunale në Prizren, Gjilan, Ferizaj, Drenas dhe në Han të Elezit...Dhe, shqyrtimi dhe miratimi i procedurave për vlerësimin e kriterëve të zotësisë juridike për fitimin e të drejtës të votës për votim jashtë Kosovës.

Në këshill, tha z. Hamiti, kemi shqyrtuar kërkesat për zëvendësime dhe konsiderojmë se janë plotësuar të gjitha kushtet, kriteret formale - juridike dhe ligjore që të trajtohen në KQZ dhe, të bëhet zëvendësimi i tyre.

Binak Vishaj: Shkojmë me radhë:

- Kush është që z. Haxhi Xhemajl, të emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Komunën e Glllogocit nga subjekti politik PDK, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm të Kuvendit Komunal z. Idriz Hysenaj.

Anëtarët e KQZ-së me vota unanime, miratuan këtë zëvendësim.

- Kush është që znj. Mevlide Sahiti, të emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Komunën e Ferizajt nga subjekti politik Lëvizja VETVENDOSJE, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm të Kuvendit Komunal znj. Arta Tahiri.

Anëtarët e KQZ-së me vota unanime, miratuan këtë zëvendësim.

- Kush është që z. Nysret Sylejmani, të emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Komunën e Ferizajt nga subjekti politik LDK, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm të Kuvendit Komunal z. Shpëtim Sojeva.

Anëtarët e KQZ-së me vota unanime, miratuan këtë zëvendësim.

- Kush është që z. Gëlzen Hasani, të emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit nga subjekti politik Partia Konservatore e Kosovës duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm të Kuvendit Komunal z. Munir Basha.

Anëtarët e KQZ-së me vota unanime, miratuan këtë zëvendësim.

- Kush është që znj. Saranda Bllaca, të emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Komunën e Gjilanit nga subjekti politik LDK, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm të Kuvendit Komunal znj. Jehona Hyseni.

Anëtarët e KQZ-së me vota unanime, miratuan këtë zëvendësim.

- Kush është që z. Florim Shkreta, të emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Komunën e Hanit të Elezit nga subjekti politik PDK, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm të Kuvendit Komunal z. Bujar Balazhi.

Anëtarët e KQZ-së me vota unanime, miratuan këtë zëvendësim.

Sami Hamiti: Në mbledhjen paraprake, gjithashtu, kemi shqyrtuar edhe miratimin e procedurave për vlerësimin e kritereve të zotësisë juridike për fitimin e së drejtës të votës për votim jashtë Kosovës. Kemi pas një debat të gjatë, tha z. Hamiti, dhe kanë kontribuar anëtarët në këtë këshill me vërejtje substanciale sepse, është vlerësuar se kjo është një punë e përgjegjshme, dhe se e njëjta duhet të shqyrtohet me prioritet. Kjo, është konsideruar që të jetë në KQZ, sepse megjithatë, është vlerësuar se duhet të dihet se cilat duhet të jenë kriteret e kësaj zotësie, por për këtë, të kemi edhe kujdes...

Betim Gjoshi: Besoj se, kjo është një nga punët më të ndjeshme. Realisht, bazuar nga praktika edhe është punuar, mirëpo dokumenti nuk e ka pasur edhe anën formalo - juridike, dhe se, unë mendoj se, te mosha duhet t'i përmbushë kriteret që, "së paku në ditën e zgjedhjeve" votuesi duhet t'i mbushë 18 vjet. I kam pasur dilemat e mia, mirëpo na është thënë se dokumenti përmbush kriteret ligjore dhe është në harmoni edhe me legjislacionin e ministrisë së brendshme dhe kuvendit të Kosovës lidhur me zotësinë...Ka mbetur që të shihen edhe konventat ndërkombëtare...

Adnan Rustemi: Për mua, si mënyrë është e tejkaluar...Nuk është ndonjë dokument i ri, por është normim që ka qenë dashur të vihet në zbatim, së paku prej 2009...Kështu që kjo është një procedurë dhe, jam për...

(Nga ky moment, mbledhja kryesohet nga kryetarja, znj. Valdete Daka)

Eshref Vishi: Kam një dokument, nuk e di nëse e keni dërguar më herët...Unë kam një formë këtu, por nuk di se cka po miratojmë...! Nuk e di se a është një dokument këtu që është hequr nga një pjesë...apo...dhe në anën tjetër, nuk kemi spastrim të tekstit...! Ka interferime, dhe praktikisht është pakës konfuz. E vlerësoj punën, por një dokument i këtillë nuk i plotëson kushtet formale për t'u adresuar në KQZ.

Adnan Rustemi: Qe, ky është dokumenti në fakt ka marrë formën por, përmbajtja është e njëjtë...Ndërhyrja është mbi dokumentin e vjetër...

Valdete Daka: Ky është materiali ku janë bërë ndërhyrjet...

Valdete Daka: Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan dokumentin e procedurave për vlerësimin e kritereve të zotësisë juridike për fitimin e së drejtës të votës për votim jashtë Kosovës, me një votë abstenimi (Eshref Vishi).

4. Këshilli për Buxhet dhe Financa;

- *Shqyrtimi i Raportit të buxhetit dhe shpenzimet për TM1-2017;*

Ilir Gashi: Në mbledhjen e kaluar kemi shqyrtuar raportin e shpenzimeve për muajt e parë të vitit 2017...tremujorin e parë, faktikisht...Kemi konstatuar se buxheti, deri më tani është shpenzuar 11.14%...Kategoritë kryesore: 1. Paga dhe mëditje: 24. 92%. 2. Mallra dhe shërbime: 1.25%. 3. Kategoritë komunale: 7. 81%. 4. Subvencionet për partitë politike: 24.62%. 5. Kategoritë kapitale: nuk ka pasur shpenzime...

E kemi miratuar, dhe rekomandojmë për miratim.

Betim Gjoshi: Kam disa pyetje. Në bazë të planit, a e kemi shpenzuar normalisht siç e kemi planifikuar...Sepse, siq na keni thënë, nëse buxheti nuk shpenzohet si duhet, pas tre muaj Qeveria ka mundësi ta tërheqë buxhetin e pashpenzuar...Ose, ndoshta ju jeni në rregull...por, a është shpenzuar si duhet...?

Eshref Vishi: Te kategoria e mallrave: Pse janë fuzionuar dy programe, dhe mbi bazën e dy programeve jepen përqindjen e shpenzimeve...Pse nuk janë ndarë...?

Enis Halimi: Po, është e vërtetë që është një përqindje e vogël e shpenzimeve, mirëpo disa kategori janë të planifikuar ashtu që shpenzimet të ndodhin në tremujorin e fundit...sepse, atëherë pagesa bëhet...dhe, janë rreth 6 milion euro...E, po ashtu edhe për shpenzimet kapitale...Vetëm kur bëhen shpenzim, atëherë ato edhe reflektojnë në raportin shpenzues...Sipas planeve, nuk mund të bëjmë shpenzime, para se ngjarjet të ndodhin...dhe, kjo reflekton kështu...!

Betim Gjoshi: M'u përgjigjët, vetëm 20%...!

Enis Halimi: Për punë të alokimeve, rrjedhës së planeve...nuk i kam shënimet, por ne jemi kujdesur që kjo të shkojë në rregull...

Betim Gjoshi: Mua më intereson planifikimi në raport me rrjedhën e parasë: nëse, është planifikuar këtë vit...sepse, buxheti nuk është e thënë që në këtë tremujorë të shpenzohet, sepse ai mund të shpenzohet në tremujorin tjetër...Mirëpo, nëse janë paraparë të shpenzohen për shembull, 15% të buxhetit, dhe janë shpenzuar 11%, a i bie që 4% janë tërheqë nga ministria, se ashtu na është thënë se ndodh...Ose, a janë bartur, po më intereson raporti i shpenzimeve me rrjedhën e parasë...?

Valdete Daka: Më shkurt: Sa është planifikuar këtë tremujorë, dhe sa është harxhuar...Dhe, to që s'janë harxhuar a kanë humbë...? Kjo është pyetja...?

Eshref Vishi: Ju keni evidentuar në raport se KQZ, është organizuar në tre programe buxhetore. Mua, më intereson programi i shpenzimeve të Sekretariatit...

Miradije Meha, drejtoresh e DAP-it. Sa i përket shpenzimeve, buxheti në total i përmban shpenzimet sipas programeve, dhe në vazhdimësi është e ndamë sipas programeve të Sekretariatit. Në fillim, është për krejt KQZ, dhe nga fq. 7 për Sekretariatit, dhe pastaj edhe për subjektet politike. Ne, kur e kemi hartuar planin, për çdo muaj e kemi bërë veç e veç...Pra, kemi pasur një borxh nga viti i kaluar, dhe ky borxh është realizuar...mirëpo, kjo do të reflekton si buxhet i shpenzuar në muajin prill. Ministria, nuk ka tërhequr asgjë...! Pra, nuk jemi rrezikuar...

Adnan Rrustemi: Te programi i zgjedhjeve, thotë se i vetmi shpenzim është 0.74% . Për çka është shpenzuar nga programi i zgjedhjeve...?

Miradije Meha: Shpenzimi është për KVV-të, nga zgjedhjet e Drenasit për Kryetar Komune.

Valdete Daka: E kam një pyetje sepse, kam një imell e 50 anëtarëve të KVV-së që nuk janë paguar...

Miradije Meha: Pagesa bëhet përmes MEF-it me listë. Pra, nuk paguhet një nga një, por me listë të grumbulluar...

Valdete Daka: Thatë që 45 mijë euro për KVV-të janë paguar në Drenas...!

Miradije Meha: Ne e kemi dërguar listën më 2016, mirëpo MEF me vendimin nr. 123 ka bërë shkurtime të buxhetore më 28 dhjetor 2016. Për fat të keq, na i ka marrë edhe ato mjetet që i kemi pasur të lira, dhe ata kanë vepruar...

Sami Hamiti: Shpejt vjen fundi i vitit...! Hiqni pagat, ajo rrjedhë shkon...edhe transferet...Problemet janë, sepse tre muaj trendet po shkojnë në atë nivel...Asnjë lëvizje nuk është bërë nga viti i kaluar...Jeni duke shkuar me të njëjtin ritëm...Apet ua merr...Nuk mund të ankoheni...por, a njësitë s'po din me i bërë kërkesat...? A, nuk mund t'ia leni fajin prokurimit. Niveli i parë, është niveli i parë...pro, grahni dhe kryeni më shpejt sepse, prapë kanë me ju mbetët...Edhe një: mos e banalizoni raportin me "1500 euro" të vitit 2010 si grant...është qesharake, në cdo raport...kjo përsëritet...Hiqeni...bre...!

Enis Halimi: Kemi planifikuar me i shpenzuar me ndonjë projekt të caktuar...Mund të blejmë libra për bibliotekën tonë...

Valdete Daka: Libra...? Ani, a duhet ta votojmë...?

Sami Hamiti: Jo duhet, ne e votojmë aq sa është...! Ne, e votojmë mos punën e tyre...?

Valdete Daka: Kush është që të votohet ky raport ?

Anëtarët e KQZ-së, votuan me vota unanime raportin tremujorë të shpenzimeve.

5. Komiteti i Auditimit

- Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës të Komitetit të Auditimit për vitin 2016

Binak Vishaj: Komiteti i Auditimit, ka pasur 6 takime dhe të cilat janë në përputhje me ligjin e Auditimit për funksionimin e këtij komiteti për vitin 2016. Ne, gjatë kësaj kohe kemi hartuar dhe miratuar planin e punës së komitetit, aktiviteti i zbatimit të rekomandimeve të auditorit gjeneral, pastaj shqyrtimi, rekomandimi si dhe monitorimi i aktiviteteve të brendshme të komitetit të auditimit...

Valdete Daka: A ka dikush pyetje...? Nëse jo, kush është për hartimin e këtij raporti...?

Anëtarët e KQZ-së miratuan raportin e punës së Komitetit të Auditimit

- Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës të Komitetit të Auditimit për vitin 2017

Binak Vishaj: Ky plan, është përgatitur në komitetin e auditimit. Ky plan, përmban aktivitetet, orarin e mbledhjeve, numrin e takimeve etj. Ne, mund t'u japim sqarimet nëse, ju kërkoni...!

Adnan Rrustemi: Dua të sigurohem se a është i njëjti dokument kur pata propozuar dhe koj që miratuar që, në këtë tremujorë të bëhet një auditim nga komiteti për kontratat për zgjedhjet e Drenasit...?

Binak Vishaj: Jo, ky është plani i Komitetit, kurse ajo bëhet në planin e auditorit.

Anëtarët e KQZ miratuan planin e punës së Komitetit të Auditimit për vitin 2017

- Njoftim për Raportin e Auditimit të Prokurimit për vitin 2016

Binak Vishaj: Ky raport, është diskutuar dhe miratuar në mbledhjen e komitetit në praninë e të gjithë anëtarëve. Raporti është aprovuar në komitetet. Ne, jemi këtu për pyetjet tuaja...!

Sami Hamiti: Pak a shumë, të gjeturat e auditorit në raportin e auditimit të zyrës së prokurimit, janë rrjedhojë e asaj që biseduam edhe më herët lidhur me rrjedhën e shpenzimeve të buxhetit. Janë disa rekomandime të nivelit të lartë. Raportet e auditimit, janë shumë të sakta dhe precize me rrjedhën e lëndës që e ka marrë, dhe e ka shqyrtua dhe analizua. Ju, duhet t'i shiqoni...! T'i shini rrjedhat... Si i keni kryer punët...?

Problemi, sa kan qenë të planifikueme, e shihni me aktivitete. Nëse keni pasur gjithë ato aktivitete, se 5 nuk i ke realizuar, 3 janë realizuar me vonesë, veç 4 janë shkuar me kohë. Në përqindje, është 40 %, e 60% janë me vonesë se s'kan filluar fare. Ka vende, ku s'ka asnjë arsytim...Për shembull, aty ku janë 2 lëndë, 2 kontrata...Nëse ai komision, cilido që ka qenë, dhe i ka vlerësuar dy kontratat të falcifikueme që shihen qartë, pra që shihet saktë që janë të falcifikueme...Te Solviti apo ku i keni, apo diku...te British

Scull dhe që ka nënshkruar i njëjti njeri me vulë të AAB-së, dhe që ka nënshkruar i njëjti zyrtarë për dy kontratat...Ai komision, se ka vlerësuar fare...

Auditori, ka thënë se nuk është në rregull...Edhe unë po them: saktë, s'është mirë...! Edhe tjetra, e pashë një tjetër...po ashtu qesharake, atje te furnizimi me tonera...e që s'ka pasur gjithë vitin...Do të thotë, e keni marrë atje ve numrin e regjistrimit si është regjistruar atje, e që ajo se ka fare veprimtari...në anën tjetër, diferencën me atë që e ka zanat këtë punë, e ka 24 mijë euro...Po, është qesharake që njeriu e merr tenderin me 4 mijë euro, kur vlera reale e asaj pune është 24 - 25 mijë...!

Cka shoh unë në këtë raport, është se njësia e prokurimit duhet të shtohet me zyrtar të rinj, të forcohet...Raporti është shumë korrekt, por uroj që Sekretariati t'i zbatojë rekomandimit.

Binak Vishaj: Ky raport, është shqyrtuar dhe dua të them se, është bërë si auditim me kërkesën tonë. Ne, e kemi sjellë, si obligim me ju njoftuar ju se cila është gjendja, cilat janë gjetjet ...

Adnan Rustemi: Raporti, përmban gjetje, raste konkrete...Për mua, është me rëndësi se cilat janë mësimet që na dalinë nga raporti i auditorit. Në nivel të përgjithshëm, për mua del se ka njohje të mangëta dhe të pasakta të ligjit të prokurimit, ka jo profesionalizëm në shkruarjen e specifikave të kërkesave nga njësitet, ka dobësi në menaxhimin e kontratave nga personat përgjegjës, por ka edhe mosnjohje të procedurave të vlerësimit dhe të përzgjedhjeve...Kështu që, tha z. Rustemi, le të zgjidhen mësimet...

Betim Gjoshi: Puna e auditorit dhe e komitetit, ka filluar të vendosë standarde. Ky, pra është funksioni: të rritet mbikëqyrja. Pra, të shihet se si të bëhet shpenzimi i buxhetit, të rritet profesionalizimi, dhe të merret më seriozisht gjetjet sepse, përsëritja e tyre qon edhe drejt veprës penale...Menaxhmenti, më shumë duhet të bashkëpunoj me auditorin...Por, edhe gjatë zhvillimit të procedurave, si dhe zbatimi i rekomandimeve të bëhet në bashkëpunim me auditorin...Gjetjet, mendoj që janë rezultat i mbikëqyrjes, dhe rritja e mbikëqyrjes duhet të bëhet edhe më tutje...

Eshref Vishi: Sa u përket gjetjeve për administratën, rekomandimet janë të obligueshme...Duhet të zbatohen, dhe të plotësohen në afatin e paraparë nga auditori i brendshëm.

Valdete Daka: Meqë, nuk e miratojmë por, veç jemi të njoftuar unë përgëzoj lidhur me raportin... E sidomos, ajo që lidhet me një rast falsifikimi...e që mund të jetë edhe vepër penale...Por, gjithsesi, me vetë faktin që një operatorë ekonomik ka përfituar në bazë të mashtrimit, meqë i ka pas dy kontrata si referencë...ky, është mashtrim sepse dikush ka përfituar nga kjo...!

Sami Hamiti: Unë, fola në përgjigjen që e ka dhënë komisioni, është qesharake...Po, ka vërejtje, ka masa dicilinore, e që këto mos të ndodhin ma...

Në fund, anëtarët e KQZ-së miratuan planin e punës të Komitetit të Auditimit për vitin 2017 dhe raportin e auditimit për vitin 2016

Të ndryshme

Nenad Rikallo: Në takimin e kaluar, kemi bërë një konkludim që zyra, ta sjell një raport me shkrim në lidhje me ngjarjet në Serpska Lista, dhe në bazë të këtij raporti ta fillojmë një debat. Ajo që unë kam kërkuar, është që të bisedojmë në lidhje me procedurat që janë shfrytëzuar me këtë rast, dhe në procedurat ligjore që ka ndërmarrë zyra...Dhe, në bazë të disa shpjegimeve që kam marrë nga zyra, unë jam i hutuar...Deputetët e Serpska Listës janë të bllokuar, dhe shpenzimet që duhet paguar, qiraja, pagesat nuk mund të bëhet dhe Serpska Lsita është e në bllokadë, dhe ata kërkojnë që të zhblllokohen...dhe, të merren parasysh kërkesat...Dhe, kërkesa të shqyrtohet dhe zyra...nuk e di...cka është në pyetje...Nuk kërkoj dhe nuk e kam qëllimin që KQZ të ndahet, për apo kundër por kërkoj të drejtën që të bisedohet në lidhje me këtë çështje...!

Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPP-së, tha se, dje ka arritur një kërkesë me shkrim të cilën z. Rikallo veç e theksoi, dhe ne jemi duke e përgatitur materialin për Këshillin për Çështje Ligjore. Sa i përket procedurës se ku është mbërri për regjistrim: ju njoftoj se dokumentacioni është në shqyrtim publik, ashtu siq e parashih ligji...I njëjti material që ju ka dërguar subjektit politik, edhe z. Rikallo është i njoftuar...Këto janë...! S'di çka duhet të bëj zyra tjetër...

B etim Gjoshi: Jam ithtar i ndërtimit të transparencës, dhe i konkluzioneve të institucionit. është fat i mirë, i kemi aplikimet për regjistrim. Procedurat, aq sa lejon rregullorja të kryhen sa më shpejt që të jetë e mundur...Mirëpo, kjo nuk na amnistionon për punën që e kemi kryer ndaj nismave qytetare...Ju e dini se, mund të kemi edhe raste të tjera, se...nuk kemi qenë në nivel në këtë drejtim, se nuk është respektuar Ligji për Zgjedhjet...nuk kemi përgatitur rregullore për nismat qytetare, madje me e respektue ligjin për financat të cilin nuk e kemi respektuar...Sepse, nismat nuk janë të një individ...sepse, të gjithë personat duhet të jenë juridik...e ne kemi vazhduar të ju japim para...Personi juridik, nuk mund të regjistrohet pa statut...e ne, në bazë të këtyre rrethanave ne kemi ardhur deri këtu...

Unë, tha z. Gjoshi, jam keqkuptuar kur kam kërkuar rregullativë ligjore, e ne nuk kemi rregullativë dytësore ligjore...Kjo, është mirë që po kuptohet, sepse nuk mund t'u ndahen mjete për personat që nuk janë juridik...Unë, si anëtar i KQZ-së kam dëshirë me pasë rregullativë, dhe ndryshe, nuk mund të punojmë drejt...Madje, rregullativa është e mangët edhe tek ligji, sepse ligji ka ndryshuar dhe ne, as ligjin nuk e kemi të harmonizuar me legjislacionin në fuqi...

Adnan Rrustemi: Kjo që u ngritë, por edhe ato që u thanë mendoj që, këto s'duhet të trajtohen në të ndryshme...Kjo çështje, është e ndërlikuar, dhe mendoj që në një nga mbledhjet e këshillit ligjorë ta trajtojmë komplet...Dhe, në të njëjtën kohë, mendoj se KQZ nuk është vetëm zbatuese e ligjit të zgjedhjet, por edhe atë të financimit të partive politike...Po, KQZ nuk mund ta tejkalojë ligjin dhe të

marrë kompetenca përtej ligjit, nuk mund ta merr këtë rol...mirëpo, për t'i zbërthyer dhe bërë të zbatueshme ligjet kjo, mund të bëhet. Për neve, nuk është ndaluar që të bëjmë rregullore...Unë, jam ithtarë: ne, duhet të përdorim edhe analogji...Po, unë kam qëndrim të njëjtë: iniciativat qytetare mundën me ekzistuar, aq më tepër ato që përfaqësohen në kuvend që etablohen tashmë, sepse ligjet ja mundësojnë. Por, ne mundemi dhe duhet si KQZ me përdorë analogjinë që e përdorim me partitë politike të paktën, për këto funksionet e bazike të funksionimit. Neve, tha z. Rrustemi, nuk na ndalon që me kërkuar që iniciativat që hyjnë në kuvend me e depozitue statutin...dhe ne, me e ditë ku të adresohemi...ne, duhet të kemi dokumente se ku me u bazuar...

Jo vetëm ky rast, por ne duhet të kemi legjislacion për këtë! Unë, s'mendoj që sot mund të diskutojmë qysh duhet, sepse s'mund të zgjidhim gjë....

Për KQZ

Binak Vishaj, anëtar i KQZ

Valdete Daka, kryearte e KQZ.....